

**DIREKTIVA NR. 98/52/KE, MBI NJË SHITESË NË DIREKTIVËN E KËSHILLIT NR. 97/80 MBI BARRËN E PROVËS NË RASTET E DISKRIMINIMIT TË BAZUAR NË GJINI, NË MBRETËRINË E BASHKUAR TË BRITANISË SË MADHE DHE IRLANDËS SË VERIUT**

*(13 korrik 1998)*

Këshilli i Bashkimit Evropian,

Duke pasur parasysh Traktatin themelues të Bashkimit Evropian dhe në veçanti Nenin 100 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin nga Komisioni,

Duke pasur parasysh propozimin nga Parlamenti Evropian,

Duke pasur parasysh Opinionin e Komitetit Ekonomik dhe Social,

Ndërkohë që Këshilli vepron në përputhje me Marrëveshjen mbi politikën sociale, bashkëlidhur Protokollit 14, mbi politikën sociale, bashkëlidhur Traktatit të KE-së dhe në veçanti nenin 2(2) të tij, miratuar me Direktivën nr. 97/80 të Këshillit;

Ndërkohë që, si rezultat, Direktiva e mësipërme nuk zbatohet në Mbretërinë e Bashkuar;

Ndërkohë që Këshilli Evropian i Amsterdimit, i mbajtur në datat gjashtëmbëdhjetë dhe shtatëmbëdhjetë korrik njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë, vuri në dukje me miratimin e marrëveshjes së Konferencës Ndërqeveritare, përfshirjen e Marrëveshjes mbi politikën sociale në Traktat dhe gjithashtu vuri në dukje që duhej gjetur një mënyrë që t'i jepnin fuqi ligjore, dëshirës së Mbretërisë së Bashkuar që të pranonte Direktivën tashmë të miratuar mbi bazën e asaj Marrëveshje dhe të atyre të cilat mund të miratoheshin para hyrjes në fuqi të Traktatit të Amsterdimit;

Ndërkohë që në Këshillin e datës njëzet e katër korrik njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë, Këshilli dhe Komisioni ranë dakord për t'ju dhënë efekt konkluzioneve të miratuara në Këshillin Evropian të Amsterdimit;

Ndërkohë që ata, gjithashtu, ranë dakord që të zbatonin të njëjtën procedurë, me ndryshimet e nevojshme, për Direktivat e reja të miratuara mbi bazën e Marrëveshjes mbi politikën sociale;

Ndërkohë që kjo Direktivë kërkon arritjen e këtij qëllimi nëpërmjet zgjerimit të Direktivës nr. 97/80 për Mbretërinë e Bashkuar;

Ndërkohë që fakti se Direktiva e Këshillit nr. 97/80, nuk zbatohet në Mbretërinë e Bashkuar, ndikon drejtpërdrejt në funksionimin e tregut të përbashkët;

Ndërkohë që zbatimi efektiv i parimit të trajtimit të barabartë për burrin dhe gruan, në veçanti lidhur me rregullat e organizimit të barrës së provës në rastet e diskriminimit të bazuar në gjini në të gjitha shtetet anëtare, do të përmirësojë funksionimin e tregut të përbashkët;

Ndërkohë që miratimi i kësaj Direktive do ta bëjë të zbatueshme Direktivën e Këshillit nr. 97/80, në Mbretërinë e Bashkuar;

Ndërkohë që, nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Direktive, termi “shtetet anëtare” në Direktivën e Këshillit nr. 97/80, do të interpretohet duke përfshirë dhe Mbretërinë e Bashkuar;

Ndërkohë që Mbretëria e Bashkuar duhet të përfitojë të njëjtën periudhë prej tre vjetësh siç kanë përfituar dhe shtetet anëtare të tjera, për t’i dhënë fuqi dispozitive të nevojshme për zbatimin e Direktivës të Këshillit nr. 97/80,

Ka miratuar këtë Direktivë:

### **Neni 1**

Pa cenuar nenin 2, Direktiva e Këshillit nr. 97/80 do të zbatohet për Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandën e Veriut.

### **Neni 2**

Paragrafi i mëposhtëm do të përfshihet pas paragrafit të parë, të nenit 7 të Direktivës së Këshillit nr. 97/80:

“Në lidhje me Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, data një janar dymijë e një në paragrafin 1 do të zëvendësohet nga data njëzet e dy korrik dymijë e një.”

### **Neni 3**

Kjo Direktivë hyn në fuqi në ditën e publikimit të saj në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian.

### **Neni 4**

Kjo Direktivë i adresohet shteteve anëtare.